


RAPORT

NDIKIMI I SHFRYTËZUESVE TË RËRËS DHE ZHAVORIT NË GJENDJEN MJEDISORE TË LUMENJVE



Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Qëllimi i raportit
3. Korniza ligjore dhe institucionale
4. Përshkrim i shkurtër i karakteristikave të lumenjve në Kosovë
5. Shkaqet e degradimit të lumenjve
6. Reagimet e institucioneve për parandalimin e degradimit
 - 6.1. Vendimet nga MMPHI
 - 6.2. Inspektimi i operatorëve shfrytëzues të rërës dhe zhavorrit
7. Përshkrimi i gjendjes mjedisore të lumenjve
 - 7.1. Evidentimi i operatorëve eksploatues në lumenj
 - 7.2. Evidentimi i lumenjve të eksploatuar dhe degraduar
 - 7.3. Sipërfaqet e degraduara të tokës nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit
8. Përmbytjet dhe erozioni
9. Efektet në mjedisin ekologjik, florë dhe faunë
10. Konkluzione dhe rekomandime

1. Hyrje

Kosova ka një rrjet të larmishëm të lumenjve të mëdhenj dhe të vegjël, akumulacione ujore artificiale dhe natyrore. Resurset ujore në përgjithësi administrohen nga MMPHI, gjegjësisht Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL). Në përgjithësi resurset ujore në vend kanë një shpërndarje gjeografike jo të barabartë prej një rajoni në tjetrin. Edhe pse Kosova vlerësohet se ka resurse të kufizuara të burimeve të ujit, burimet ekzistuese duke përfshirë edhe lumenjtë janë shfrytëzuar dhe ndotur pa ndonjë kriter të lejueshëm ligjore.

Gjendja mjedisore e lumenjve është përkeqësuar shumë si rezultat i degradimit fizik të shtretërve, shkarkimit të ujërave të përdorura urbane dhe industriale, erozionit dhe shfrytëzimit të tokave pa kriter, përgjatë shtretërve të tyre.

Pothuajse, në çdo pellg lumor kemi degradim të tyre, me theks të veçantë në Pellgun e Drinit të Bardhë. Lumenjtë tanë, pas vitit 1999 e kënde, pa përjashtuar të kaluarën e mëparshme, i janë nënshtruar një presioni të vazhdueshëm të eksploatimit dhe shfrytëzimit nga personat fizikë dhe juridik (operatorët ekonomik). Shumë lumenj të vendit janë shndërruar jo vetëm si kolektor të ujërave të përdorura urbane, industriale por edhe vend shfrytëzimi pa kriter i inerteve.

Respektimi dhe zbatimi i kriterëve ligjore për shfrytëzimin e lumenjëve për inerte janë jashtë çdo normative përkundër që shumica e operatorëve kanë Pëlqime apo Leje Mjedisore për shfrytëzim. Forma e shfrytëzimit të inerteve dhe rehabilitimit të sipërfaqeve të degraduara janë jashtë çdo standardi të zhvillimit të qëndrueshëm apo edhe të mundësisë së rehabilitimit natyrorë vetvetiu të lumenjëve. Shfrytëzimi i inerteve të lumenjve ka kaluar të gjitha limitet e mundësisë natyrore që lumenjtë të kthehen në gjendjen e mëparshme. Ky tej shfrytëzim dhe degradim i lumenjve ka rrjedhur edhe si pasojë e nevojave të mëdha të inerteve për infrastrukturë të banimit, industriale apo rrugore.

Kohët kanë ndryshuar, duke lënë pas periudhën emergjente të ndërtimit, dhe tani është emergjente kthimi i kujdesit për lumenjtë tanë, të cilët duhet të mbrohen dhe të rehabilitohen dhe të rikthehen në gjendjen e tyre natyrore. Institucionet përgjegjëse duhet të veprojnë shpejtë sipas kërkesave ligjore duke ndaluar këtë dukuri, më qëllim që mos të vije deri të pamundësia e rikthimit të lumenjëve në gjendje normale. Zhvillimi ynë varet nga planifikimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i lumenjve, një standard i cili mundëson që edhe gjeneratat e reja të trashëgojnë këtë pasuri natyrore.

2. Qëllimi i raportit

Degradimi i sipërfaqeve të lumenjëve është si pasojë e mbi shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit, nga operatorët legal dhe ilegal dhe tejkalimi i kapacitetit të prurjes natyrale të tyre.

Raporti, **Ndikimi i Shfrytëzuesve të Rërës dhe Zhavorrit në Gjendjes Mjedisore të Lumenjve** ka si objektiv kryesor vlerësimin e gjendjes mjedisore të lumenjëve të ndikuar nga shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit, evidentimin e sipërfaqes së degraduar, masat e ndërmarra nga institucionet në përputhje me kërkesat ligjore, rregulloret, udhëzimet administrative dhe standardet tjera mjedisore si dhe efektet e tyre për përmirësimin e gjendjes.

Ky vlerësim ka për qëllim po ashtu që të evidentojë edhe ndikimet negative dhe efektet në florë, faunë dhe peizazhin e ekosistemeve të lumenjëve të ndikuara nga shfrytëzimi i inerteve, evidentimin e dëmeve dhe efekteve tjera mjedisore si dhe të informojë institucionet dhe publikun e gjerë për gjendjen aktuale të lumenjëve.

Raporti vlerësues, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjes mjedisore të lumenjve, bazuar në të gjeturat kryesore ka nxjerrë edhe një listë masash dhe veprimesh që duhet të zbatohen ndaj degraduesve, për ndërprerjen e degradimit të mëtejshëm si dhe përmirësimin e kushteve mjedisore të lumenjve.

3. Korniza ligjore dhe institucionale

Kuadri ligjor me të cilin trajtohet dhe rregullohet aktiviteti i eksploatimit të rërës dhe zhavorrit si dhe vlerësimit të gjendjes mjedisore janë:

- 1) Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- 2) Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- 3) Ligji Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- 4) Ligji për Miniera dhe Minerale
- 5) Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
- 6) Ligji Nr. 2004/29 për Pyjet e Kosovës
- 7) Ligji Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor
- 8) Ligji Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim Pronës së Paluajtshme të Komunës

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Ky ligj (Nr. 03/L-025) ka përkufizuar “lejen mjedisore” si dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria i cili kërkohet me qëllim që të merret leja e punës.

Sipas këtij ligji, Ministria, me akt nënligjor, përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, formën e aplikimit, përmbajtjen e lejes mjedisore, revokimin e lejes, vazhdimin e vlefshmërisë si dhe regjistrin e lejeve të lëshuara

Neni 10 i këtij ligji përcakton se asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

Ligji për Ujërat e Kosovës

Qëllimi i këtij ligji për lumenjtë e Kosovës është mbrojtja e brigjeve të ujë-rrjedhave dhe akumulimeve (Neni 48);

1. Me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, të e ndaluar janë veprimet :

1.1. ndërrimi i drejtimit të ujit në ujë-rrjedha dhe kanale;

1.2. nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, deponimi i dheut, hedhja e mbeturinave, materialeve të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta në ujë- rrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre;

1.3. ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmytjet në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujë rrjedhave dhe akumulimeve;

1.4. kryerja e punëve në afërsi të ujë -rrjedhave, liqeneve, akumulimeve, tuneleve të cilat do të mund të rrezikojnë stabilitetin e objekteve mbrojtëse ose përdorimin e tyre, si dhe transportimin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme;

2. Ndërrimi i drejtimit, nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, ndërtimi i objekteve, kryhet vetëm nën kushtet, mënyrën dhe procedurat e caktuara sipas këtij ligji.

3. Kushtet, kriteret dhe procedurat përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Me këtë Ligj (Nr. 03/L-214) rregullohet identifikimi projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis, dhe procedurat shoqëruese administrative gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ky ligj ka përcaktuar (në shtojcat e ligjit) që për veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis siç janë gurthyesit, seperacionet etj., duhet të duhet të hartohet vlerësimi i ndikimit në mjedis. Kriteret për këtë ekzaminim janë dhënë në shtojcën 3.

Ligji për Miniera dhe Minerale

Ky ligj (Ligji Nr. 03/L-163) rregullon hulumtimin dhe shfrytëzimin e resurseve minerale në Republikën e Kosovës.

Me këtë ligj resurset minerale përkufizohen si: “çfarëdo minerali metalik, industrial, ndërtimor, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar, mineral energjetik ose ujë që ka vlerë potenciale ekonomike.” Me nenin 4 këtij ligji përcaktohet se ky ligj zbatohet për të gjitha aktivitetet e hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale në Kosovë.

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Me këtë ligj (Ligji Nr. 03/L-233) rregullohen mbrojtja e natyrës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i saj dhe veçanërisht mbrojtja, ruajtja, përtëritja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore.

Neni 5, paragrafi 1.3. Parimi ,shfrytëzuesi paguan – kur shfrytëzon natyrën ,shfrytëzuesi është i detyruar që të paguaj për lartësinë e shpenzimeve të mirëmbajtjes së baraspeshës natyrore dhe shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore si dhe të sanoj dëmtimet e natyrës që kanë ndodhur gjatë shfrytëzimit të natyrës dhe trashëgimisë natyrore.

Ligji për Pyjet e Kosovës

Qëllimi i këtij ligji është ruajtja menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të gjitha llojet e pyjeve. Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) 7.1 Autoriteti Pyjor i Kosovës, i themeluar me Direktivën Administrative 2000/23 të UNMIK-ut, i ndryshuar, i transferuar që vepron nën autoritetin e Ministrisë si një Agjenci Ekzekutive dhe i riemëruar me këtë ligj në APK e që është përgjegjës për çështjet e ndërlidhura në rregullimin e pyjeve, tokave pyjore private, menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe tokave pyjore publike si dhe pyjeve në parqet nacionale në Kosovë.

Agjencia e Pyjeve të Kosovës është institucioni përgjegjëse për dhënien në shfrytëzim të tokave dhe pronave pyjore edhe për gurthyesit dhe rrjedhimisht kur prona është tokë pyjore, operatori nuk mund të paraqes kërkesë për pëlqim mjedisor pa kontratën për qiranë e tokës të nënshkruar nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës.

Ligji për Planifikim Hapësinor

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe të siguroj qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët.

Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale

Me këtë ligj (nr. 04/L-144) rregullohet mënyra e dhënies në shfrytëzim dhe në këmbim personave fizik dhe juridik e pronës Komunale.

Ky ligj përcakton qartë se dhënia në shfrytëzim e pronës Komunale, qoftë afatshkurtër (1 deri 15 vite) ose afatgjatë (15 deri 99 vite) duhet të bëhet përmes konkurrencës së hapur publike.

Përgjegjësit institucionale për leje të shfrytëzimit, operimit, pëlqim mjedisor dhe licencë

Përgjegjësit e institucioneve në lidhje me administrimin, menaxhimin e resurseve natyrore si dhe dhënien e lejeve, licencave dhe pëlqimeve mjedisore qoftë për eksploatim të rërës dhe zhavorrit, shfrytëzim apo operim, janë si :

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lëshon pëlqimin mjedisor,
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lëshon pëlqimin ujor, lejen ujore dhe lejen mjedisore, si dokument të fundit me të cilin operatori mund të filloj ligjërisht aktivitetin.
- Komuna e lëshon: Pëlqimin për Operim, përgjigje qe lejohet veprimtaria dhe njoftim urbanistik për aktivitetet qe lejohen për zonën në fjalë,
- Agjencia e Pyjeve të Kosovës lëshon leje për shfrytëzimin e tokës pyjore.
- Komisioni për Miniera dhe Minerale lëshon licenca për hulumtim, shfrytëzim dhe leje për aktivitete të veçanta.

4. Përshkrim i shkurtër i karakteristikave të lumenjve në Kosovë

Uji është resurs natyror me shpërndarje jo të barabartë në kohë dhe hapësirë. Nga fakti se të gjitha format e jetës dhe të gjitha aktivitetet njerëzore, shumë apo pak, janë të lidhura me ujin, qartë del rëndësia e ujit dhe dokumentet e rëndësishme të cilat këtë marrëdhënie e rregullojnë.

Zhvillimi ekonomik dhe urbanizimi sjell, në një rën anë me rritjen rapide të nevojave për ujë dhe në anën tjetër paraqet rrezik për resurset ujore në aspektin e ndotjes. Kështu që uji mund të jetë faktor kufizues i zhvillimit socio – ekonomik në vendin tonë.

Resurset ujore (RU) në Kosovë janë të kufizuara me shpërndarje jo të barabartë gjithëvjetore. Resurset ujore sipërfaqësore janë: lumenjtë, burimet (krojet), akumulimet artificiale, përroskat me rrjedhje të përkohshme dhe të përhershme.

Ndryshueshmëria e tyre vit pas viti është shumë e lartë. Shumica e lumenjve paraqesin model shumë të çrregullt të rrjedhjes sezonale. Rrjedhjet e lumenjve janë më të larta gjatë dimrit ose në fillim të pranverës.

Lumenjtë nuk janë vështirë për t'u kontrolluar, nga fakti se të gjithë lidhen me rrugë deri te burimi. Nuk kemi as një lumë në të cilin mund të lundrohet.

Një vend mjaft me rëndësi në zhvillimin ekonomik-shoqëror zënë edhe ujërat nëntokësorë. Ujërat nëntokësorë si të tilla në tërë territorin e Kosovës nuk janë të hulumtuara në shkallën e duhur. Në pjesën e regjionit perëndimor (rrafshi i Dukagjinit) janë të hulumtuara dhe të konstatuara pjesa më e madhe e ujërave nëntokësorë, për deri sa në regjionin lindor (rrafshi i Fushës së Kosovës), ku kemi edhe pjesën më të madhe të vendbanimeve, industrisë dhe tokave bujqësore, kemi mungesë të ujërave sipërfaqësore si dhe ngecë shumë hulumtimi i ujërave nëntokësorë të cilat do të ishin me rëndësi të konsiderueshme për furnizimin e vendbanimeve me ujë për pije, mandej edhe për sektorët tjerë konsumues.

Ndarja e territorit të Kosovës në njësi ujore

Territori i Kosovës është i ndarë nga katër vija ujëndarëse (pellgje ujëmbledhëse) të cilat kanë diktuar edhe rrjedhjen e ujërave në drejtime të ndryshme (Tab.1.)

Tab.1. Pellgjet ujore në Kosovë

Pellgu	Sipërfaqja km ²
Pellgu i Drinit të Bardhë	4622 km ²
Pellgu Ibrit	4009 km ²
Pellgu Moravës së Binçës	1564 km ²
Pellgu i Lepecit	0.685 km ²

Lumenjtë kryesore të pellgjeve ujëmbledhës janë si në tabelën 2.

Tabela.2. Lumenjtë kryesore të Pellgjeve ujëmbledhës në Kosovë

Lumenjtë kryesor	Gjatësia (km)	Sipërfaqja km ²
Drini i Bardhë	122	4.622
Lumbardhi i Pejës	62	424.9
Lumbardhi i Prizrenit	31	262.6
Ereniku	51	510.3
Ibri	42	1.155
Sitnica	90	2.861
Morava e Binçës	60	1.552
Lepenci	53	679.0

Lumi Drini i Bardhë

Drini i Bardhë buron në një lartësi mbidetare 567m, afër fshatit Radavc rreze malit Rusoli. Formohet nga dy burime ujore, i majti është me konstant pasi nuk ndikohet nga reshjet, dhe i djathti që gjatë stinëve me reshje të konsiderueshme sjell sasi të mëdha të ujërave.

Krahas prurjes së volumit të madh të ujit, Drini i Bardh sjell sasi të mëdha të rërës dhe zhavorrit përgjatë shtratit qarkullues. Te dy burimet bashkohen dhe formojnë një ujëvarë interesante me një lartësi prej 25m, i cili prej këtu e deri në vende derdhje në Lumëbardhin (Bistricën) e Deçanit me lartësi 349m, me një distance prej 46 km, ka pjerrtësi mesatare prej 4.7 m/km., dhe që nga këtu rrjedh si lum i qete fushore ku formon një lugine te gjere.

Nëse merret për bazë e gjithë rrjedhja e këtij lumi prej burimi 567m e deri në Vermicë 270m lartësi mbidetare, mund te karakterizohet si lum fushor me pjerrtësi mesatare 2.7 m/km. Pjesët me te gjera te luginës janë ato te fshatit Radavc dhe Terstenik ku dhe marrin emrin Luginat e Mëdha.

Ne këtë pjese, Drini i Bardhë arrin një gjerësi prej 1-2 km, gjë që nëse krahasojmë bregun e majtë, ai i djathti dallohet me një pjerrtësi më të madhe ndaj Drinit te Bardhe. Pjesa e dytë e zgjeruar e Drinit te Bardhe shtrihet prej lokalitetit Stub e deri ne Dellove, ku dhe formon Fushën e Drinit, lugine kjo me një gjerësi prej 3 km , shtrati i tije arrin 10-15m.

Degët te djathta të Drinit te Bardhë janë : Lumi Sushice, Lumbardhi i Pejës dhe ai i Deçanit. Degët e majta të Drinit te Bardhë janë: Lumi Istog, Klina, Mirusha, Toplluga dhe Lumbardhi i Prizrenit. Drini i Bardhë te Ura e Fshajte ka pasur një prurje prej 5-7m³/s.



Fig.1.Lumi i Drinit të Bardhë (Maj, 2022)

Lumbardhi i Pejës

Është lumi me i gjatë (62km) i rrjetit hidografik të Drinit të Bardhë. Pellgu i saj ka një sipërfaqe prej 500 km². Buron në një lartësi mbidetare 2.243 m, i cili prej burimit e deri në Pejë me një lartësi 505m, ka një diferencë mjaft të madhe vertikale prej 1738 m, gjegjësisht ka një pjerrtësi mesatare prej 28 m/km. Shtrati i këtij lumi është i ngushtë dhe i thellë, i cili sa vjen e zgjerohet në afërsi të grykë derdhjes së tij që arrin gjerësinë 10-15m. Ky lum në këtë sektor ka një pjerrtësi mesatare prej 150 m ose mesatarisht 4.6 m/km.

Degët kryesore të Lumëbardhit të Pejës janë: Lumi Haxhaj me degën Stankaj, Reka e Allagës, Sheu i Keq, Bogë dhe Milishevcit. Me përjashtim të kësaj të fundit të tjerat janë degët e Majta të L. Bardhit. Degët e Lumëbardhit të Pejës, për shkak të relievit të pjerrët dhe pjerrtësisë së madhe kanë fuqi të madhe erozive. Konsiderohet se të gjitha këto sjellin dhe depozitojnë 806 m³ materiale të eroduar në pjesët e poshtme të Lumëbardhit të Pejës.



Fig.2. Lumi i Lumëbardhit të Pejës (Maj, 2022)

Lumi Sushicë

Është një lum tipik malor. Ky lum nga burimi e deri në vendederdhjen në Drinin e Bardhë, përshkon një distance prej 19 km. Ka një pjerrtësi mesatare prej 72 m/km. Përshkon brigjet e majave me të larta (Majës se Hasanit, Gurit Bellopaq, Majes Vjelak, Plekinit etj.), ku formon luginën e thellë në formë të kanionit.

Këtu mbizotëron erozioni intensiv në thellësi, kurse në afërsi të fshatit Brestovikë është deponuar po thuaj i tërë materiali i eroduar. Ky lum depoziton në këtë vendbanim një sasi prej $1.283 \text{ m}^3/\text{km}^2$, duke i shkaktuar dëme të mëdha këtij vendbanimi. Kohëve të fundit janë marrë masa më qellim të parandalimit të kësaj dukurie ku janë ngrit edhe diga si dhe është bërë pyllëzimi, por jo në mënyrë efikase.

Karakterizohet me prurje te ndryshueshme gjate stinëve që ndikohet nga të reshurat dhe shkrirja e akullit. Në pranverë arrin sasinë maksimale të prurjes $200 \text{ m}^3/\text{sek.}$, ndërsa gjate verës dhe dimrit arrin minimumin 0.25 deri $0.37 \text{ m}^3/\text{sek.}$



Fig.3. Lumi i Sushicës (Qershor, 2022)

Lumbardhi i Deçanit

Buron ne majën e Pasji Verh të lartësisë mbidetare prej 2.281 m. Ka një gjatësi të qarkullimit prej 53km, dhe me një pjerrtësi mesatare 36m/km, si lum malor. Pjerrtësinë me të madhe mesatare e arrin në pjesët e epërme 80m/km. Ndërsa prej Deçanit deri në grykëderdhje në Drinin e Bardhë në Mrasorë , është rrjedhe me e qetë dhe ka gjerësi prej 100 m.

Lumbardhi i Deçanit pasurohet me ujë rreth 82 degëve të tij. Si degë më kryesore mund të veçohen: Lumi Kozhnjarit, me degët tjera dhe kanë fuqi të madhe erozive.

Lumbardhi i Deçanit sjellë mesatarisht $900 \text{ m}^3/\text{km}^2$ ne vit material të eroduar.



Fig.4. Lumi i Lumbardhit të Deçanit (Qershor 2022)

Lumi i Istogut

Buron në rrëzat e Mokra-Gorës afër Istogut. Lumi rrjedh nepër fushën e ulët të Istogu me një pjerrtësi mesatare 14m/km. Në pjesën e epërme, gjerësia e shtrati arrin 4m, kurse në atë të poshtëm 1-6 m. Degët kryesore të Lumit Istog janë: Catishi, Sushica dhe Vrellë.



Fig.5. Burimi i Lumit të Istogut, (Qershor 2022)

Lumi i Klinës

Pas Lumit të Pejës është dega me e gjatë (60 km) e Drini të Bardhë në këtë regjion. Lumi i Klinës buron nga shpatet verilindore të Malit të Thatë në jug të liqenit artificial Ujmanit në lumin Ibër. Shtratin e vet e ka thelluar në gëlqerore e që ka krijuar brigje relativisht të pjerrta. Prurjen mesatare e ka $2.35 \text{ m}^3/\text{sek}$, që pas lumit, degët më të rëndësishme të këtij lumi janë rrjedhat e Klisurës, Jashanicës dhe Murgës.



Fig.6. Lumi Klina (Qershori, 2022)

Lumi Toplluha

Toplluha është një lum që shtrihet në Rrafshin e Dukagjinit, si degë e majtë e lumit Drini i Bardhë e që rrjedh në pjesën jug-lindore të Rrafshit të Dukagjinit. Pellgu përgjithshëm i lumit Toplluha ka një sipërfaqe prej rreth 504 km² dhe për nga madhësia është pellgu i dytë më i madh i lumit Drini i Bardhë, pas pellgut të Erenikut.¹ Në pjesën e epërme është me tepër lum malor me luginë të thellë dhe te ngushtë i cili prej burimit e deri në Suharekë zbret për 611m ose 47m/km. Toplluha prej Reçanit e deri në grykëderdhje merr tiparet e lumit fushor i cili zbret për 84 m ose 3.5m/km.

Lumi Toplluha në afërsi të fshatit Piranë derdhet në lumin Drini i Bardhë. Degët më të rëndësishme të këtij lumi janë: Lumi i Leshanit, Korishës, Optrushës, Semetishtit, Drakaçinës etj.



Fig.7. Lumi Toplluha (Qershor, 2022)

¹ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Toplluha>

Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve

Lumbardhi i Prizrenit

Lumbardhi i Prizrenit buron në shpatet e malit Bistra në lartësi mbidetare 2540 m dhe i cili rrjedh përgjatë Maleve të Sharrit. Lumbardhi i Prizrenit ka një gjatësi të qarkullimit 35.5 km deri në derdhje në Drinin e bardhë si dhe me një sipërfaqe të pellgut prej 279 km².

Degët më të rëndësishme të Lumbardhit të Prizrenit janë: Shartica, Lubinja, Jabllanica dhe lumi i Manastirit. Sistemin hidrografik të Lumbardhit të Prizrenit e përbejnë 72 rrjedha ujore të vogla. Ka një prurje mesatare 6,90m³/sek. Lumbardhi i Prizrenit prej burimit e deri ne Prizren është lum malore dhe i rrëmbyeshëm me një diference vertikale 2,257 m dhe një pjerrtësi mesatare prej 72,8m /km.



Fig.8. Lumi i Lumbardhit të Prizrenit (Maj, 2022)

Lumi Ereniku

Është lumi kryesor në Regjionin e Gjakovës. Buron prej liqeneve akullnajore të Gjeravicës i cili derdhet në Drinin e Bardhë ne afërsi te Urës së Fshejt. Ka gjatësi prej 51 km dhe njihet më tepër si lumë fushor pasi që 2/3 e gjatësisë i kalon ne një sipërfaqe me pikën me të lartë prej 300-500 m të lartësisë mbidetare. Në pjesën e epërme të qarkullimit të lumit shtrihen lugina e ngushtë dhe e thellë e cila zgjerohet duke filluar nga fshati i Junikut e deri në grykëderdhjen e Drini të Bardhë. Lumi Ereniku ka fuqi të madhe erozive, ku edhe deponon sasi të mëdha të materialeve të erodiuera në rrafshje.

Ka një sistem mjaft të zhvilluar hidrografik i cili përbëhet prej 80 rrjedhave me një gjatësi të gjithmbarshme afro 494 km.

Degët e djathta te Erenikut janë te shumta, të shkurta me pjerrësi po thuajse vertikale dhe me rrjedhje jo mirë të zhvilluar.

Prej degëve të majta dallohen Lumbardhi i Lloçanit i cili buron në lartësinë e quajtur Ploça në perëndim të majës se Gjeravicës. Kjo rrjedhë kalon nëpër Gjakovë dhe derdhet në Erenik me emrin Krena. Ka gjatësi 35.2 km dhe është lumi me i gjatë ne rajonin e Gjakovës.

Trava buron në malin Zhac, është dege e majtë dhe ka me tepër tipare të lumit fushor, me prurje të vogël të ujit.



Fig.9. Lumi i Erenikut (Maj, 2022)

Lumi Ibër

Buron në shpatet veriore të Halisë dhe është burim karstik. Kompleksi malor i Halisë, Shtedimit dhe Mokna Gorës bëjnë ujëndarësin e Pellgut të Ibrit në veri dhe Drinit të Bardhe në jug. Lumi i Ibrit është i rrëmbyeshëm dhe me pjerrtësi mesatare rreth 6,71m/km.

Gjerësia e shtratit të lumit të Ibrit, në vendburim është 2 - 5 m, në Rozhajë zgjerohet deri 10m, kurse në Mitrovicë arrin gjerësia rreth 20 – 25 m. Degët të cilat gravitojnë kah Ibrin në territorin e Rrafshit të Kosovës janë rrjedhje të vogla kryesisht malore që dallohen me oscilime të theksuara në prurje. Lumenjtë që shkarkohen në anën e djathtë të lumit Ibër janë: lumi Sitnicë, Bistrica Socanica dhe lumi Dren, ndërsa nga ana e majtë degët më të rëndësishme janë lumi Banjaska dhe Jashanicë.



Fig.10. Lumi i Ibrit (Prill, 2022)

Lumi Sitnicë

Lumi Sitnicë është lum fushorë i cili përshkon gjithë rrafshin e Kosovës. Degët e tij më të rëndësishme janë; ana e majtë; lumi Drenicë dhe Shtime, ndërsa ana e djathtë Graçanka, Prishtevka, Llapi dhe lumin Shtime të cilat bashkohen afër fshatit Robovc duke formuar lumin Sitnica. Prej këtu e deri në vend derdhje në lumin Iber në Mitrovicë ajo kalon një gjatësi prej 90km.

Karakterizohet me një pjerrtësi shumë të vogël i cili ka tiparet e lumit fushor me pjerrtësi mesatare prej 0,54m/km. Rrjedh përgjatë Fushës së Kosovës duke zgjeruar shtratin nëpër rrafshinat aluviale.

Në pjesën e epërme të rrjedhës arrin gjerësinë e shtratit afër 6m, ndërsa në territorin e Mitrovicës shtrati i lumit zgjerohet prej 20-25m.

Ajo dallon jo vetëm për nga prurjet e vogla vjetore por edhe për ndryshimet të theksuara në prurje gjatë vitit. Prurjet minimale arrinë në $Q_{min.}=2,5m^3/s$, dhe $Q_{max}=37,7m^3/s$. Prurjet me të theksuara i ka në dimër dhe në pranverë, ku dhe bën dëme të mëdha në fushat prej Lipjanit deri në Mitrovicë.

Në anën e djathtë lumi Sitnica mbledhë ujërat e Gadimës, Janjevës, të Gracankës, të Prishtinës të Llapit dhe Samodrazhës. Ana e majtë e Sitnicës mbledhë ujërat e Drenicës dhe Lushtës.



Fig.11. Lumi Sitnica (Qershor 2022)

Lumi i Llapit

Lumi Llap buron në shpatet jug-lindore të Kopaunikut, në majën e quajtur Pilatovicë (1.703 m) dhe është degë e rëndësishme dhe më e gjata (79.4 km) e Sitnicës.

Ka një pjerrtësi 23.1 m/km, me shtrat të gjerë deri më 6m në pjesën hyrëse në rrafshin e Kosovës. Në pjesën e Rrafshit të Kosovës, ka tiparet e lumit fushore me një pjerrtësi 4.05 m/km, me gjerësi të shtratit afro 10 m, dhe thellësi 1m. Lumi i Llapit derdhet në lumin Sitnica afër lokalitetit të ashtuquajtur Reka e Madhe.

Prurjet mesatare mujore sillen prej 12,5m³/s në mars dhe atë me të vogël në shtator me 0,78m³/s. Prurjet vjetore arrin 5,4m³/s.

Degët kryesore të Lumit Llap janë: Lumi Kaçandoll, Dubnicë dhe Batllavë.



Fig.12. Lumi i Llapit (Qershor, 2022)

Lumi Batllavë

Lumin Batllavë e formojnë degët Ballaban dhe Turiqicë të cilat bashkohen afër fshatit Orllan dhe së bashku derdhen në liqenin e Batllavës. Lumi i Batllavës është degë e majtë e lumit të Llapit ndërsa rrjedha e tij kalon nëpër fshatrat Batllavë dhe Orllan.



Fig.13. Lumi i Batllavës (Qershor, 2022)

Lumi Drenicë

Lumi Drenicë buron në Bretenc (1.046 m) të Mali Caraleva. Ka një pellg prej 477m² dhe gjatësi prej 50.5 km. Në pjesën e epërme të Drenicës prej burimit deri te fshati Poklek, lugina e këtij lumi arrin gjerësinë 2-4 km, kurse gjerësinë e shtratit deri 4m.

Në veri të Pjetershticës e deri në Drenas(Gllogoc) ka një pjerrtësi të vogël me një shtrat të gjerë dhe me tiparet e një lumi fushor. Nga Drenasi e deri në Bellaqevc ka formuar një shtrat të ngushtë me pjerrtësi dhe thellësi të theksuar e që nuk i kalon 5 m gjerësi. Me të dalë nga gryka, lumi zgjerohet dhe arrin gjerësinë 8-10 m. Gjithashtu në këtë zonë i zvogëlohet pjerrtësia ku dhe merr tiparet e një lumi fushor. Lumi Drenicë derdhet në lumin Sitnicë.

Prurja mesatare e Drenicës në Sitnicë është 2.0 m³/s.




Fig.14. Lumi Drenica (Maj, 2022)

Lumi Morava e Binçës

Ky lum krijohet prej dy burimeve të cilat burojnë në shpatet veriore të Karadaku të Shkupit. Njëra prej burimit ka emrin Golema Reka dhe tjetra Morava e Binçes, të cilat bashkohen në lokalitetin e quajtur Binçë nga edhe e merr emrin.

Gjatësia e lumit në territorin e Kosovës është 60 km me një madhësi të pellgut hidrografik prej 1,175 km². Në pjesën e epërme është lum i shpejt me pjerrtësi të madhe, me shtrat të ngushtë e të thellë dhe me erozion vertikal të theksuar. Në rrjedhën e mëtuqeshme lumi kalon nëpër fushën e Gjilanit me një gjatësi 24 km. Në këtë lokalitet ka një shtrat me të zgjeruar dhe pjerrtësi me të vogël. Në fshatin Doberçan lumi hynë në grykën e Gjilanit me një gjatësi prej 16 km, i përshkuar me një shtrat të thellë, të ngushtë dhe me brigje të pjerrëta. Në dalje të grykës në afërsi të fshatit Ranillug dhe Krojmir i Ulët, shtrati i lumit përsëri zgjerohet afro 10 km. Në këtë pjesë merr degën e majtë të lumit Kriva Reka dhe se bashku me Moravën formon gryken e Konçulit para se të derdhet në Moravën Jugore.

Prurjet mesatare mujore janë mjaftë te theksuara të cilat varësisht prej sezonës sillen prej 2.89 m³/s - 3.56 m³/s.

Degët e djathtë të Moravës së Binçës janë: Lumi Letinca, Karadaku, Pasjani dhe Donjareka, përkatësisht Podgradska. Këto degë dallohet për nga gjatësia e tyre shumë e shkurtër dhe me fuqi të madhe erozive.

Degët e majta të Moravës së Binçës janë: Lumi i Zhitise, Cernicës, Livoçit, Golema dhe Krivareka. Lumi Krivareka dallohet jo vetëm për gjatësinë, prurjet si dhe madhësinë e pellgut (612 km²).

Si veçori e përgjithshme e degëve të Moravës së Binçës është intensiteti i madhe i erozionit dhe akumulimi i tij në pjesën e poshtme të fushës së Gjilanit. Për këtë dukuri dallohet me së shumti lumi i Letincës dhe i Prilepnicës.



Fig.15. Lumi Morava i Binçës (Qershor, 2022)

Lumi Lepenc

Buron në shpatet veriore të malit Sharr të Oshlakut në lartësi 2212 m mbi nivelin e detit. Në territorin e Kosovës ka një gjatësi prej 53 km, me një sipërfaqe të pellgut 607 km² dhe prurje mesatare vjetore 7,9m³/s. Prurjet mesatare arrin prej 13.0m³/s- 15,5m³/s. Lepenci pasurohet shumë edhe nga rrjedhjet e vogla që zbresin prej pjesës malore, të cilat kanë një rrjedhe të shkurtë dhe me pjerrtësi të theksuar. Janë të rrëmbyeshëm që dallohen për nga fuqia e madhe erozive si dhe për nga akumulimi i materialit eroziv në pjesët e poshtme. Proces ky i ndihmuar edhe nga vegjetacioni i mangët që mbizotëron këtë regjion. Dega me e rëndësishme e Lepencit është lumi Nerodime.



Fig.16. Lumi Lepenc (Qershor, 2022)

Lumi Nerodime

Lumi i Nerodimës buron në malin e Nerodimës te maja Studenicë në një lartësi 1.123 m mbi nivelin e detit. Gjatësia e Nerodimes është 41.3 km, me një sipërfaqe të pellgut prej 228 km², me një prurje mesatare vjetore 2.1m³/s.

Lumi Nerodime është e njohur në literaturën gjeografike për fenomenin e bigëzimit (Bifurkacionit).

Fenomeni i Bifurkacionit janë të rralla në botë, ndërsa në kontinentin tonë është i vetmi fenomen.



Fig.17. Lumi i Nerodimës (Qershori, 2022)

5. Shkaqet e degradimit të lumenjve

Procesi i degradimit të lumenjve është një problem socio-ekonomik. Degradimi i lumenjve nuk është problem aktual por një problem i përcjellë me vite të tëra në vend. Degradimi në mënyrë intezive ka ndodhur në dy deceniet e fundit, andaj sfida qëndron në gjetjen e mënyrave për të plotësuar nevojat tona pa prishur ekuilibrin ekologjik në përgjithësi të lumenjve tanë.

Ekzistojnë definime të ndryshme rreth nocionit të degradimit të mjedisit. Varësisht prej shkallës dhe formës së degradimit, qoftë fizikë, kimik apo biologjik, në këtë raport janë disa definime të degradimit mjedisor:

- Degradimi i mjedisit është një proces përmes të cilit mjedisi natyror rrezikohet në atë mënyre që redukton diversitetin biologjik dhe shëndetin e përgjithshëm të mjedisit. Ky proces mund të jetë krejtësisht i natyrshëm në origjinë ose mund të përshpejtohet ose shkaktohet nga aktivitetet njerëzore. Shumë organizata ndërkombëtare e njohin degradimin mjedisor si një nga kërcënimet kryesore me të cilat përballet planeti pasi njerëzve u është dhënë vetëm një Tokë për të punuar me të dhe nëse mjedisi komprometohet në mënyrë të pariparueshme, kjo mund të nënkuptojë fundin e ekzistencës njerëzore.²
- Degradimi i mjedisit është shpërbërja e tokës ose përkeqësimi i mjedisit nëpërmjet konsumit të aseteve, për shembull ajrit, ujit dhe tokës; shkatërrimin e mjediseve dhe zhdukjen e kafshëve të egra. Karakterizohet si çdo ndryshim ose përkeqësim në terrenin e natyrës që shihet si i dëmshëm ose i padëshirueshëm.³
- Degradimi i mjedisit është një përkeqësim i mjedisit nëpërmjet varfërimit të burimeve natyrore që çon në shkatërrimin e ekosistemeve dhe zhdukjen e kafshëve të egra⁵.
- Një pellg lumi mund të quhet i degraduar nëse produktiviteti natyror, disponueshmëria e ujit dhe kapaciteti i tij për të absorbuar ndikimet e ngjarjeve ekstreme përkeqësohen nga ai i kohërave paraprake, industriale apo zhvillimit operativ. Për të vlerësuar degradimin, duhet të krahasohet reagimi i pellgut me reagimin e tij përpara ndërhyrjeve njerëzore. Por qeniet njerëzore janë pjesë e natyrës dhe veprimet e tyre për të përmbushur nevojat e tyre janë të natyrshëm.⁴
- Shkarkimi ose shkatërrimi i një burimi potencialisht të rinovueshëm si: toka, livadhet, pyjet ose kafshët e egra duke e përdorur atë me një ritëm më të shpejtë se sa rimbushet natyrshëm. Nëse një përdorim i tillë vazhdon, burimi mund të bëhet i pa ripërtëritshëm në një shkallë kohore njerëzore ose mund të mos ekzistojë (zhduket).⁵

² <https://www.eionet.europa.eu/gemet/en/concept/15154>(26.05.2022)

³ <https://www.conserve-energy-future.com/causes-and-effects-of-environmental-degradation.php>(20.05.2022)

⁴ Saving the degraded river basin(<https://www.downtoearth.org.in/blog/water/saving-the-degraded-river-basin-65931>). 27.05.2022

⁵ <https://www.igi-global.com/dictionary/environmental-degradation/10060>(26.04.2022)

Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve

Procesi i degradimit mund të ndodhë natyrshëm, por aktivitete e shfrytëzimit pa një zhvillim të qëndrueshëm si praktika të pahijshme kanë përkeqësuar gjendjen, duke krijuar skenarë të riparueshëm të peizazheve të lumenjve.

Më këtë rast ndërveprimi i këtyre faktorëve nga ndikuar në ndryshimin dhe prishjen e peisazhit dhe shtratit të lumenjve si forma morfologjike të tyre. Meqenëse lumi në procesin natyrorë është dinamik, ato ndryshojnë vazhdimisht si në hapësirë ashtu edhe në kohë, shfrytëzimi pa kritere të rërës dhe zhavorrit nga aktivitetet e njeriut kanë ndikuar që ky dinamizëm natyrorë të ndryshojë dhe të marr formën e degradimit të riparueshëm.

Morfologjia e lumenjve mund të kategorizohet në degradim, zgjerim dhe agradim (agradimi është grumbullimi i sedimentit në kanalit e lumit, duke shkaktuar rritjen e lartësisë së shtratit të lumit).⁶

⁶ *Environmental Degradation: A Review on the Potential Impact of River Morphology. Awang Nasrizal Awang Ali et al. ISCEE 2016*

Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve

6. Reagimet e institucioneve për parandalimin e degradimit

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për administrimin e resurseve ujore, me theks të veçantë të lumenjve. Përkundër angazhimeve nga përgjegjësit e institucioneve për mbrojtjen e resurseve ujore nga degradimi, vlerësohet se efektiviteti i tyre në mbrojtjen e resurseve natyrore ishte jo në nivelin e duhur.

Duhet përmendur se monitorimi, inspektimi, programet apo edhe planet e integruara të luftës kundër degradimit të lumenjve dhe eksploatimit të rërës dhe zhavorrit ka ndikuar edhe nga faktorët socio-ekonomik, mungesa e vullnetit dhe kryesori ishte ndikimi politik. Këta faktorë kanë ndikuar që eksploatimi i inerteve nga lumenjtë të jenë jashtë çdo limiti edhe përkundër Vendimit të Qeverisë e cila mund të llogaritet me një ndikim jo edhe aq të madh në parandalimin e eksploatimit.

6.1.Vendimet nga MMPHI

Gjatë gjithë këtyre viteve, më përjashtim të infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e ujërave, është marr vetëm një vendim i cili kishte si qëllim parandalimin e eksploatimit të rërës dhe zhavorrit (Vendimi i Ministrit -Nr.02/46, datë 02.11.2011). Vendimi i Qeverisë së Kosovës për ndalim të kësaj veprimtarie në fillim u kundërshtua nga eksploatuesit, të cilët e dërguan rastin në gjykatë. Për vetëm disa ditë Gjykata Supreme mori vendim për pezullim të vendimit të qeverisë. Megjithatë qeveria bashkë me organizata e individë që merren me mbrojtjen e mjedisit u ankuan në këtë gjykatë, gjë që rezultoi me revokim të vendimit të mëparshëm. Vendimi përkundër pritjeve për zbatim, operatoret legal dhe ilegal vepronin në eksploatimin e zhavorrit dhe rërës pa ndonjë kriter. Gjatë kësaj periudhë të Vendimit, Inspektorati Mjedisor i MMPH ka realizuar gjithsej 103 inspektime në terren të seperacioneve të rërës dhe zhavorrit në gjithë territorin e Kosovës.

Inspektimet kanë vijuar kryesisht në lumenjtë ku ka pasur degradime me të mëdha si ne:

- Komunën e Prizrenit: Lumbardhi i Prizrenit
- Komunën e Rahovecit: Drini i Bardhë
- Komunën e Gjakovës: Lumi i Erenikut
- Komunën e Pejës: Lumbardhi i Pejës
- Komunën e Kamenicës: Lumi Krivareka
- Komunën e Vushtrrisë: Lumi Sitnica
- Komunën e Mitrovicës: Lumi Ibër

Gjatë kohës sa ai ishte në fuqi, kompanitë ilegale vazhduan të dëmtojnë lumenjtë gjithandej Kosovës. Sipas Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) në periudhën 2009-2014 janë evidentuar 178 operues ilegalë të cilët kanë kryer 207 operime ilegale. Sipas vlerësimeve ky numër ishte edhe më i madh.

Gjatë kësaj kohe inspektorati i mjedisit si masë ndëshkuese ndaj operatoreve për mos respektimin e Vendimit operatoreve i ‘u është tërhequr vërejtja me procesverbal si dhe janë bërë inicime në Gjykatën për Kundërvajtje. Si masë ndëshkuese në Gjykata për Kundërvajtje janë dërguar gjithsej 34 operatore, ku 16 prej tyre janë shqyrtuar nga Gjykatat në nivel të Kosovës. Gjithashtu pas Vendimit Nr.02/46 janë bërë 21 konfiskime të makinerisë me ndihmën e KPMM dhe Policisë së Kosovës.

6.2. Inspektimi i operatorëve shfrytëzues të rërës dhe zhavorrit

Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë bazuar në të dhëna për periudhën 2019-2021 ka realizuar rreth 200 inspektime me procesverbal ndaj operatoreve fizik dhe juridik (seperues), si eksploatues që veprojnë dhe operojnë në afërsi të lumenjve të Kosovës, shih tab.3. Bazuar në inspektimet e realizuara dhe konstatimit të gjendjes në terren, Inspektorati i MMPHI-së ka ndërmarrë masa në bazë të shkeljeve ligjore që janë hasur në terren, duke nxjerr vendime për ndalim të aktivitete, ndëshkim me gjoba, inicime kundërvajtëse dhe penale.

Gjatë vitit 2019 , Inspektorati i MMPHI dhe Policinë e Kosovës-Drejtoria e Krimeve të Rënda, KPMM, APK, Policia Rajonale dhe Inspektoratet komunale kanë zhvilluar inspektime të përbashkëta në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe Komunitet e Mitroviës Veriore, Zveçan dhe Leposaviq, tek operatorët me aktivitet për resurse minerare, duke përfshi edhe inspektimet në sepercione - shfrytëzim i inertëve të lumenjve.

Inspektimet kanë vijuar kryesisht në lumenj ku ka pasur degradime me të mëdha si në: Komunën e Prizrenit(pjesën e Drinit të Bardhë), Komunën e Rahovecit(pjesën e Drini i Bardhë), Komunën e Gjakovës(Lumi i Erenikut), Komunën e Pejës(Lumbardhi i Pejës), Komunën e Kamenicës(Lumi Krivareka dhe Desivojc), Komunën e Vushtrisë (Lumi Sitnica), Komunën e Mitrovicës(Lumi Ibër). Gjatë këtyre aksioneve inspektues janë hasur - vërejtur degradime të mëdha nëpër brigjet e lumenjve dhe në përgjithësi të peizazheve natyrore.

Bazuar në gjendjen në terren Inspektorati i MMPHI-së, ka ndërmarr masa ndaj operatorëve që operojnë afër shtratit të lumenjve, të cilët operonin në mungesë të dokumentacionit si dhe ndaj atyre që janë hasur duke operuar ilegalisht.

Në vitin 2020 nuk kemi mundur ta realizojmë planin e punës në tërësi për shkak të situatës së pandemisë, ndërsa në vitin 2021 Inspektorati i MMPHI-së ka zhvilluar inspektime tek resurset minerare duke i përfshi edhe sepercione të inerteve të lumit, mirëpo në pa mundësi që të inspektohet edhe gjendja e lumenjve.

Tabela 3. Aktivitetet e realizuara të Inspektoratit të MMPHI, gjatë viteve 2019-2021

Vitet	Aktivitete	Numri
2019-2021	Procesverbale	200
	Vendime për ndalim pune	118
	Inicime penale	7
	Inicime kundërvajtëse	24
	Gjopa	93

Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve

Disa fotografi të realizuara nga Inspektoriati i MMPHI gjatë vitit 2019, në kuadër të inspektimeve në disa lumenj të Kosovës janë prezantuar në vijim të këtij raporti.

Rajoni i Prizrenit



Fig. 18. Pjesa e degraduar në Lumin Drini i Bardhë

Rajoni i Pejës



Fig.19. Pjesa e degraduar në Lumbardhin e Pejës



Fig.20. Pjesa e degraduar në Lumbardhin e Pejës

Rajoni i Kamenicës



Fig. 21. Pjesa e degraduar në Lumin Krivareka




Fig.22. Pjesa e degraduar në Lumin Krivarekë

Rajoni i Gjakovës



Fig. 23. Pjesa e degraduar nga shtrati i Lumit Erenik

7. Përshkrimi i gjendjes mjedisore të lumenjve

Në lumenjtë e evidentuar si më të degraduarit janë konstatuar disa forma të dëmtimit fizik të peizazheve dhe brigjeve të shtretërve të lumenjve.

Format më të shpeshta të degradimit janë përcjell me pasojat si:

- Ulja e lartësisë së shtratit të lumit,
- Zgjerimi i shtretërve,
- Ndryshimi i rrjedhës së ujërave,
- Dëmtimi i substratit të florës përgjatë brigjeve të lumenjve,
- Hapja e gropave të mëdha nga eksploatimi i inerteve,
- Dëmtimi i substratit të florës dhe arealit të faunës,
- Dëmtimin e ekosistemit të lumit etj.

Zgjerimi i shtretërve të lumenjve nga këto aktivitete i ka paraprirë edhe zgjerimi i mëtutjeshëm nga procesi natyror i erozionit si rezultat i gërryerjes dhe heqjes së bimëve drunore dhe shkurreve. Më këtë aktivitet qoftë nga njeriu apo edhe atij natyror është bërë rritja e gjerësisë së brigjeve dhe shtretërve të disa pjesë të lumenjve të vendit.

Vlerësimi i gjendjes mjedisore të lumenjve, e në veçanti i formës së degradimit fizik është një proces jo i lehtë për të analizuar në mungesë të shumë të dhënave zinxhiror si: mungesa e një rregullore për normat e aplikueshme të shkallës së degradimit dhe efekteve në proces, volumit të sasisë së eksploator të rërës dhe zhavorrit, aktiviteti ilegal apo legal etj.

Vlerësimi i gjendjes së lumenjve është bazuar nga monitorimi direkt në terren, matjet me GPS për përcaktim të pozicioneve me detaje, marrja e fotove nga vendngjarja. Metoda për përcaktimin e sipërfaqeve të degraduar është bërë nga imazhet satelitore të ortofotove të viteve 2008/2014/2018, si dhe studimeve dhe modeleve krahasuese ndërkombëtare.

7.1. Evidentimi i operatorëve eksploatues në lumenj

Identifikim i operatoreve eksploatues të rërës dhe zhavorrit është bërë përmes analizimit dhe sistemimit të dosjeve në MMPHI, si: pëlqimet mjedisore, lejet mjedisore, licencat e shfrytëzimit të resursit mineral.

Në këtë identifikim janë përfshirë të gjitha komunat e Kosovës të cilat kanë kërkuar leje mjedisore dhe pëlqime mjedisore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Qytetet në territorin e Kosovës të cilat kanë numrin më të madh të seperacioneve janë në komunën e Pejës, Klinë, Istog, Suharekë, Rahovec, Prizren, Viti, Gjilan, Mitrovicë Malishevë etj. Sipas listës që posedon MMPHI deri fillim të vitit 2022, në këto qytete ekzistojnë një numër i madh i operatoreve të cilët operojnë apo në pritje të marrjes së Lejes Mjedisore, shih tabelën 4.

Tabela 4. Numri i operatoreve që operojnë dhe në pritje të Lejes Mjedisore për disa komuna

PEJË 30	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Thërrmim, ▪ Bluarje, ▪ Seperim të rërës dhe zhavorrit, ▪ Seperacion, ▪ Thyerje, ▪ Eksploatim, ▪ Eksploatim i inerteve, ▪ Seperim të inerteve, ▪ Shfrytëzim, ▪ Betonjere dhe seperim ▪ Bazë e betonit.
KLINË 20	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Eksploatim, ▪ Thërrmim, ▪ Seperim i gurit gëlqeror, ▪ Bazë për prodhimin e betonit, ▪ Gurthyes me seperacion, ▪ Gurthyes me seperim të gurit gëlqeror, ▪ Nxjerrje e gurit gëlqeror dhe seperim i gurit me granulacion, ▪ Gurthyes me seperacion dhe fabrikë e llaçit të thatë, ▪ Nxjerrja e gurit dhe seperim i gurit granulat, ▪ Seperim të rërës dhe zhavorrit, ▪ Fabrikë për prodhimin e betonit dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Shfrytëzim i gurit gëlqeror,
ISTOG 10	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Eksploatim, thërrmim dhe seperim bazë e betonit, ▪ Impiant për thyerje, bluarje dhe klasifikim të rërës dhe zhavorrit gurit gëlqeror, ▪ Shfrytëzim, thërrmim dhe seperim të rërës, ▪ Eksploatim thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror,
SUHAREKË 15	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Eksploatim i gurit gëlqeror, thërrmim, seperimin dhe prodhimin e betonit, ▪ Shfrytëzim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror dhe prodhim të betonit, ▪ Seperim te inerteve,

RAHOVEC 6	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Thërrmim dhe seperim i rërës dhe zhavorrit, ▪ Eksploatim i gurit gëlqeror, ▪ Bazë e betonit si dhe seperacion i rërës dhe zhavorrit, ▪ Seperim i rërës dhe zhavorrit si dhe bazë për prodhimin e betonit, ▪ Eksploatim, thërrmim dhe sepërimit i gurit gëlqeror,
PRIZEREN 20	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Seperim i rërës dhe zhavorrit, ▪ Bazë e asfaltit, baze betoni, seperacion, ▪ Gurthyes me seperacion, ▪ Eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Seperim të inerteve dhe bazë e betonit, ▪ Thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Seperim i rërës dhe zhavorrit, ▪ Eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Shfrytëzim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit eruptive,
VITI 7	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gurthyes me seperacionin e gurit gëlqeror, ▪ Thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, ▪ Eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Shfrytëzim, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror,
GJILAN 11	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gurthyes – Seperacion, ▪ Eksploatim, ▪ Thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Shfrytëzim, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, ▪ Bazë e betonit dhe seperim i rërës dhe zhavorrit,
MITROVICË 4	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Seperim i rërës dhe zhavorrit, ▪ Prodhim i detergjenteve liquide dhe ambalazhit pet dhe polietilen, ▪ Eksploatim, ▪ Thërrmim dhe seperim të inerteve
MALISHEVË 4	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gurthyes me seperacion të gurit gëlqeror, ▪ Eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, ▪ Thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror,
TOTAL	127

7.2. Evidentimi i lumenjve të eksploatuar dhe degraduar

Gjatë muajt shkurt-maj 2022, janë monitoruar Drinin e Bardhë, Lumëbardhin e Pejës, Erenikun e Gjakovës, Lumëbardhin e Prizrenit, Lumëbardhin e Decanit, Lumi i Istogut, Lumi Klina, Morava e Bincës, Desivojçë dhe Krivareke ne Kamenicë, Ibrin ne Mitrovicë, Lepencin ne Kaçanik dhe Han të Elezit, Sitnica, Lumi Drenicës dhe Llapi. Gjatë monitorimit të lumenjve janë identifikuar forma të ndryshme te degradimit si pasojë e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit. Si vlerësim i gjendjes mjedisore janë marrë në konsideratë karakteristikat e mundshme fizike natyrore të shtretërve të lumenjve dhe format e degradimit të lumit te rezultuar nga nxjerrja e rërës dhe zhavorrit. Nga monitorimi në terren, kemi gjetur këtë gjendje të lumenjve nga degradimi, shih tab. 5.

Tabela 5. Gjendja mjedisore e lumenjve nga monitorimi në terren

Lumenjtë	Pjesa e lumit	Gjendja mjedisore
Drini i Bardhë	- Burimi me bashkërrjedhjen e Istogut -Bashkërrjedhja nga Istogu drejtim Rakovines -Rakovina deri ne Gjonaj	- I pa dëmtuar -Punimet kanë shkaktuar dëme -Punimet kanë shkaktuar dëme
Lumbardhi i Pejës	-Nga burimi deri ne Pejë -Nga Peja deri ne bashkimin me Drinin e Bardhe	- I pa dëmtuar - I degraduar dhe i dëmtuar ne vazhdimësi
Istogu	Degë i tërë	I pa dëmtuar
Klinë	Degë i tërë	I pa dëmtuar
Lumbardhi i Deçanit	-Degë e tërë	- I pa dëmtuar
Lumbardhi i Prizrenit	Dega e tere	Nuk janë evidentuar dëmtime
Ereniku	-Nga burimi deri ne Junik -Nga Juniku deri ne Shishman -Shishmani deri ne Gjakove - Bashkimin me Drinin e Bardhe	-I pa dëmtuar -Pa dëmtime te mëdha - Dëme evidente -Dëme evidente
Lepeci	-Nga burimi deri ne Doganaj -Doganaj ne Kacanik -Kacanik ne drejtim te rrjedhës	-I pa dëmtuar -Pa dëmtime - Evidente dëmtimet te lehta
Morava e Bincës	Shtrati i lumit afer Kamenicës	-I dëmtuar
Desivojce	Lajqice	-I dëmtuar
Krivareke	Domorovc dhe Hajnovc	I dëmtuar
Ibri	Mitrovicë	drejtim te rrjedhës - Dëmtimi evident
Lumi i Drenices	Degë e tërë	-I pa dëmtuar
Llapi	Degë e tërë	I pa dëmtuar
Sitnica	Degë i tërë	I pa dëmtuar

Të gjeturat e evidentuara nga monitorimi janë:

- Ndryshimi fizik i rrjedhës së lumenjve dhe zgjerimi i pakontrolluar i shtretërve;
- Devijim i rrjedhës natyrale të ujërave;
- Nga ekspozimi i rërës dhe zhavorrit janë krijuar thellësira dhe hendeqe të shumta gjatë rrjedhës së lumenjve;
- Me degradimin e shtretërve të lumenjve është rritur shkalla e erozionit të tokës dhe vërshimeve;
- Ndërprerjet parciale të lumit dhe zvogëlimin e minimumit biologjik të rrjedhës së ujërave;
- Shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit për tej masave të rikthimit natyrore nga lumenjtë;
- Degradim të sipërfaqeve të tokës përgjatë shtretërve të lumenjve;
- Paqëndrueshmëri dhe prishje e brigjeve të lumit;
- Ndikimi në ndryshimin natyror të ekosistemit të lumit, florës dhe faunës.

Disa fotografi që prezantojnë degradimin e lumenjeve të realizuara gjatë vitit 2022



*Fig.24. Rahovec-Degradimi i Lumit Drini i Bardhë, lokacioni ne mes te fshatit Rakovinë dhe Qiflak.
(Maj, 2022)*



Fig. 25. Pejë - Degradimi i Lumit Lumbardhi i Pejës, lokacioni ne mes të fshatit Poqestë, Gllaviçicë dhe Leshan (Maj, 2022)



Fig.26. Gjakovë-Degradimi i Lumit Erenik-lokacioni Shishman (Maj, 2022),



Fig.27. Mitrovicë - Degradimi i Lumit të Ibrit, lokacioni i Zupçës (Maj, 2022)



Fig.28. Kamenicë- Degradimi i Lumit Desivojcë, lokacioni Desivojcë (Prill, 2022)

Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve

7.3. Degradimi i sipërfaqeve të tokës nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit

Lumenjtë tanë me vite të tëra ju kanë nënshtruar një presioni të vazhdueshëm të eksploatimit të rërës dhe zhavorrit dhe si pasojë janë degraduar sipërfaqe të tëra të shtretërve dhe tokave për rreth tyre. Sipërfaqet e degraduar nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit deri në vitin 2018 është vlerësuar se është 1421.06 ha. Që nga vitit 2008 e deri në vitin 2018, sipërfaqja degraduese e lumenjve është rritur për 414.78 ha.⁷

Mënyra dhe metoda e vlerësimit të pjesëve të degraduara është bërë mbi bazën e modeleve krahasuese të imazheve satelitore të ortofotove 2008/2012/2018, si dhe imazheve nga terreni.

Pas rivektorizimit të sipërfaqeve të degradueshme për 2018 është vlerësuar se kjo sipërfaqe e degraduar është rritur edhe për 341.65 ha, që do të thotë në total është 1762.71 ha. (tabela 6).

Tabela 6. Sipërfaqet e degraduara të disa lumenjve në Kosovë

Kodi	Lumi	Ha 2008	Ha 2012	Ha 2018
1	Drini i Bardhë	861.1	1011.75	1393.04
2	Ibri	2.64	4.5	8.48
3	Morava e Binçës	4.29	4.79	8.29
103	Lumbardhi i Pejës	93.36	136.34	257.12
108	Ereniku	16.28	19.48	39.78
301	Kremenadë (Krivareka)	19.37	25.26	25.68
502	Desivojcë	7.76	18.95	18.91
2436	Shipashnica	-	-	11.41
	Gjithsej	1004.77	1221.07	1762.71

Degradimi i Lumit Drini Bardhë 2012-2018

⁷ Raport, Gjendja e ujërave në Kosovë 2020- MMPHI/AMMK

Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve




Fig. 29. Degradimi i lumit Drini i Bardhë përgjatë lokacioneve të fshatrave Doblëbarë dhe Bardhosanë të Komunës së Gjakovës si dhe Dobidolë, Dejë dhe Ratkoc të Komunës së Rahovecit

Degradimi i Lumit të Lumbardhit të Pejës 2012-2018




Fig.30. Degradimi i Lumit të Lumbardhit të Pejës përgjatë lokacioneve të fashatrave Gllaviqicë, Leshan, Kerstoc, Kliqirë dhe Jabllanicë në Komunën e Pejës

Degradimi i Lumit të Erenikut të Gjakovës 2012-2018




Fig.31. Degradimi i Lumit të Erenikut përgjatë lokacioneve të fshatrave Pjetërshtan, Kushavec dhe Zidi i Sadik Ages në Komunën e Gjakovës.

Degradimi i Lumit të Moravës së Binçës 2012-2018




Fig.32. Degradimi i Lumit të Moravës së Binçës përgjatë lokacioneve të fshatrave Dobërçan të Komunës së Gjilanit dhe Glllogoc të Komunës së Ranillikut.

Degradimi i Lumit Ibër 2012-2018

Nxjerrja e rërës dhe zhavorrit përgjatë shtratit të Lumit Ibër nuk është e nivelit të theksuar. Në rrjedhën e poshtme të lumit në lokacionin Zubçë vrehen sipërfaqe të prekura nga eksploatimi për shkak të vëllimeve më të mëdha të sedimenteve të përziera. Veçanërisht vrehet një degradim i sipërfaqeve të tokës punuese përgjatë Lumit Ibër. Sipërfaqja e degraduar për periudhën kohore 2009-2018 vlerësohet se është 8.48 ha.




Fig.33. Degradimi i Lumit Ibër përgjatë lokacioneve të fshatrave Zubçë dhe Çabër të komunës së Zubin Potokut.

Degradimi i Lumit Shipashnicë 2012---2018




Fig.34. Degradimi i Lumit të Shipashnicës përgjatë lokacioneve të fshatrave Shipashnicë e Epërme dhe Shipashnicë e Poshtme në Komunën e Kamenicës.

Degradimi i Lumit Kremenadë (Krivarekë) 2012-2018




Fig. 35. Degradimi i Lumit Kremenadë (Krivarekë) përgjatë lokacioneve të fshatrave Koretin dhe Topanicë në Komunën e Kamenicës.

Degradimi i Lumit të Desivojcës 2012-2018




Fig. 36. Degradimi i Lumit Desivojcë përgjatë lokacioneve të fshatrave Velegllavë e Poshtme dhe Lajçiq në Komunën e Kamenicës.

8. Përmbytjet dhe erozioni

Përmbytja është dukuri natyrore e shkaktuar nga nivele të larta të ujit në lumenj dhe daljes së ujit nga shtrati i tij duke përmbytur brigjet e zonës përreth.

Përmbytjet janë pasojë e tejkalimit të kapacitetit të lumit për të bartur tërë sasinë e ujit nga shtrati i tij. Kjo vije gjatë reshjeve intensive të shiut dhe gjatë shkrirjes së shpejtë së borës, ku sistemi lumorë ngarkohet tej mase dhe duke u bazuar edhe në faktorët të tjerë natyrorë siç janë orografia e terrenit, pjerrtësia, përbërja gjeologjike e tokës, vegjetacioni etj. ndikojnë që lumenjtë ose disa degë të tyre, shpesh herë të dalin nga shtrati i tyre dhe të shkaktojnë përmbytje gjegjësisht të vërshojnë, duke shkaktuar dëme në toka bujqësore, shtëpi banimi, objekte ekonomike, infrastrukturë e ndonjëherë edhe në humbje jetës së njerëzve.

Në vendin ton më shpesh paraqiten përmbytjet gjegjësisht vërshimet të shpejta të shkaktuara nga stuhitë e forta të pasuara me rrebesh shiu ose nga shkrirja e shpejtë e borës, të cilat në terminologjinë hidrologjike njihen si vërshime të shpejta (anglisht “Flash Flood”).

Përmbytjet si dukuri natyrore, lidhen gjithashtu me mungesë të mirëmbajtjes së argjinaturave dhe pritave mbrojtëse përgjatë shtretërve të lumenjve të cilat janë shpesh here të dëmtuara apo nuk janë mirëmbajtur si duhet, por edhe mos hartimi i ndonjë plani konkret të investimeve në riparimin dhe mirëmbajtjen e rregullt të tyre.

Konsiderohet se në kuadër të fatkeqësive natyrore, përmbytjet marrin pjesë me rreth 40 %.

Shkaqet direkte të përmbytjeve janë:

- Intensiteti i lartë i reshjeve të shiut;
- Shkrirja e shpejt e borës;
- Kalimi i kapaciteteve natyrore bartëse ose transportuese të lumit.

Kosova përbëhet nga dy fushëgropa (Dukagjinit në perëndim dhe Kosovës në lindje) të rrethuar nga Alpet Shqiptare në perëndim (Gjeravica 2656 m), Malet e Sharrit në jug dhe Kopaonikut në veri. Kjo pozitë gjeografike ka ndikuar që lumenjtë të rrjedhin shpejt, sidomos gjatë reshjeve intensive të shiut dhe kur bora shkrihet shpejt duke paraqitur përmbytje në disa zona.

Vërshimet e shpejta shkaktojnë më shumë se 5000 vdekje në mbarë botën çdo vit, duke tejkualuar çdo ngjarje tjetër të lidhur me përmbytjet. Ndërsa popullsia globale rritet, veçanërisht në zonat urbane, të cilat vazhdojnë të shtrihen në fushat e përmbytjeve, prandaj nevoja për ngritjen dhe zhvillimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm të përmbytjeve bëhet shumë urgjente.

Në vitin 2021, mbi 3 miliardë njerëzve në 67 vende të botës u jepen paralajmërimet të hershme për përmbytje të shpejta të mundshme përmes Shërbimeve të tyre Kombëtare Meteorologjike dhe Hidrologjike që punojnë në bashkëpunim me Agjencitë e tyre Kombëtare të Menaxhimit të Fatkeqësive.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës bën paralajmërim të hershëm të vërshimeve, duke u bazuar fillimisht në ngritjen e kapaciteteve të saja monitoruese me stacione automatike meteorologjike dhe hidrologjike, zhvillimin, aplikimin si dhe avancimin e modeleve parashikuese dhe paralajmëruese por edhe në bashkëpunimin dhe anëtarësim në organizata dhe institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Rrjeti nacional Hidrometrik i Kosovës përbehet prej 35 stacioneve hidrologjike ku 16 prej tyre janë online, ndërsa ai meteorologjik përbehet prej 12 stacioneve ku 11 prej tyre janë online.

Për lumenjtë kryesorë të Kosovës gjegjësisht në profilet kryesore hidrometrike, janë krijuar grafikët apo të ashtu quajturat “pragje të vërshimeve”, të cilat janë të ndërlidhura me sistemet e paralajmërimit të hershëm gjegjësisht pajisjet senzorigje dhe telemetrike, të cilat ofrojnë informacione gati në kohë reale.

Pellgu i Ibrit

Sitnica përmyt territoret e Fushë Kosovës në disa segmente të caktuara në rrjedhën e tij të mesme dhe të poshtme deri në Mitrovicë.

Drenica, gjatë rrebeshve të shiut dhe gjatë shkrirjes së shpejtë të borës del nga shtrati dhe përmyt disa pjesë të fshatrave: Çikatovë e Vjetër, Nekoc, Dobroshec, Gllanasellë, Zabel i Poshtëm, Poklek, Tërstenik, Polluzhë, Vërboc etj.

Llapi përmyt tokat bujqësore në rrjedhën e tij të mesme (Podujevë) dhe të poshtme, duke filluar nga Lluzhani deri në Lupç të Poshtëm.

Pellgu i Moravës së Binçës

Të prekur nga përmytjet janë fusha në afërsi të fshatrave Pasjan, Velekincë, Budrik e Ulët, Uglar, Ranillug, Korminjan, Domarovic etj, ndaj edhe në lumin e Moravës së Binçës janë bërë matje gjeodezike dhe është kryer modelimi i përmytjeve në teritorin mes fshatrave Velekincë, Pasjan dhe Budrigë.

Pellgu i Lepencit

Karakteri tepër i përthyer i relievit në pellgun ujëmbledhës të këtij lumi krijon kushte të përshtatshme për vërshime gjatë rrjedhës së mesme dhe poshtme, sidomos në Kaçanik dhe Han të Elezit, ndërsa Lumi i Nerodimës zakonisht shkakton përmytje nga qyteti i Ferizajt duke përfshirë disa lagje në anën perëndimore të qytetit deri në Kaçanik 64, duke përfshirë fshatrat Balaj, Nikadin, Varosh, Kosinë etj.⁸

⁸ *Hydro-climatic disaster and warning, (Flood Freecast System – FFS), Regional workshop “Identification of EU and Regional Best Practices on Flood Risk Management Plans and Expert Exchange on Integration of Early Warnings in Emergency Response Planning” Dr. Bashkim Kastrati, March 2022, Albania*

Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve

PËRMBYTJET NË KOSOVË

Përmbytjet e shkaktuara nga lumi Sitnica pranë Obiliqit (24.02.2006)



Përmbytjet e shkaktuara nga lumi Llapi në Lupç të Ulët (22.02.2010)

Fig. 37. Përmbytjet e shkaktuara nga Lumenjtë Sitnica dhe Llapi 2006&2010


PËRMBYTJET NË KOSOVË

Zonat më të shpeshta të përmbytura në Kosovë

Zonat e rrezikut nga përmbytjet
në Piranë: Lumi Toplluha



Zonat e rrezikut nga përmbytjet:
Gjonaj - Drini Bardhë



Source: Map from Master Plan 1983-2000

Zonat e rrezikut nga përmbytjet
Obiliq: Sitnica



Zonat e rrezikut nga përmbytjet:
Lipjan - Sitnica

Fig. 38. Përmbytjet e shkaktuara nga Lumenjtë Drini Bardh, Sitnica dhe Lumi Toplluha



Fig. 39. Përmytjet e shkaktuara nga Lumi Sitnica në Komunën e Vushtrrisë-2020



Fig. 40. Përmytjet e shkaktuara nga lumenjtë Morava e Binçës, Drini Bardhë, Drenica në vitin 2021

Erozioni - është prezent në tërë territorin e Kosovës. Erozioni shfaqet në forma të ndryshme, si gërryerje sipërfaqësore e tokës, brigjeve të lumenjve, e përrenjve, transport i depozitimeve të ngurta e të rërës, zhavorreve, lymit etj. Erozioni në Kosovë me fuqinë e vetë gërryese brenda një viti krijohet produkt për bartje ~12mil/m³/vit. Nga ky material i eroduar për bartje arrihet të bartet rreth 5 mil/m³ në vit ose rreth 460m³/km² ose rreth 5m³/ha.⁹

Kosova krahasuar me Shqipërinë 20-25 t/ha/vit ose rreth 60 mil/vit ka shkallë më të ulët eroziv. Shkaqet e erozionit si fenomen shkaktohen nga një kombinim faktorësh siç janë: kushtet meteorologjike-reshurat, shkalla e pjerrtësisë së terrenit, përdorimi i pa përshtatshëm i tokës, shkatërrimet ekologjike të tokës, siç janë: djegia e bimësisë, prerja e pa kontrolluar e pyjeve, shpyllëzimet, mungesa e investimeve për mbrojtjen e tokave, për ndërtimin e pritave malore, etj.

Janë të përcaktuara pesë (5) kategori te erozionit dhe varësisht nga përmasat e përhapjes së kësaj dukurie në vend, janë paraqitur me sipërfaqe në km², dhe në përqindje (tabela 7) Pjesëmarrja e sipërfaqeve sipas kategorisë së erozionit janë:

Tabela 7. Sipërfaqet e degraduara të disa lumenjve në Kosovë

Kategoritë	Sip në km ²	%
Kategoria e parë	714.3	6.6
Kategoria e dytë	1890.2	17.6
Kategoria e tretë	3367.7	31.3
Kategoria e katërt	3680.2	34.3
Kategoria e pestë	1097.5	10.2

Pra erozioni i kategorive I,II,III dhe IV përfshijnë sipërfaqen prej 9652.4 km² ose 89.8% nga sipërfaqja e përgjithshme. Sipas vlerësimeve nga institucionet përgjegjëse, produktiviteti me i avancuar i aluvioneve është në rrjedhën e sipërme të Lumit Ibër. Po ashtu edhe sipërfaqet e pellgu të Lepencit janë të rrezikuara nga erozioni. Pastaj vijnë Pellgjet e Drinit të Bardhë dhe Moravës së Binçës. Produktiviteti me i vogël i erozionit është në Lumin Sitnica.

⁹ "Veçoritë fiziko – gjeografike dhe Vlerësimi Ekonomik i pasurive Natyrore", Dr. Bashkim Kastrati, "Disertacion i doktoratës, fq. 89 – 91, Tiranë 2014.

Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve




Fig.41. Harta e erozionit në Kosovë

9. Efektet në mjedisin ekologjik, florë dhe faunë

Ndryshimi i morfologjisë së shtretërve të lumenjve nga efekti i degradimit ka ndikim në ekosistemin përreth dhe gjithashtu në cilësinë e ujit. Procesi i degradimit të tokës mund të përshpejtojë erozionin sipërfaqësor, gërryerjen e pjesëve të tokës dhe thellimin e shtratit në formë të gropave të cekëta dhe thella. Gjatë eksploatimit të rërës dhe zhavorrit si një formë me e theksuar e degradimit, rritet niveli i sedimenteve të pezulluar e më këtë edhe nivelin e turbullirës që redukton depërtimin e dritës në ujë, ndikon negativisht në habitatin ujqor. Më zvogëlimin i sipërfaqes ose anëve të shtretërve ndikon në humbjen e substratit të shumë drunjëve e më këtë edhe humbjen e bimëve, si një formë e cila do të përshpejton procesin e erozionit. Erozioni i tokës në lum degradon cilësinë e ujit. Në një periudhë të caktuar kohore, mund të ndodhë rrëshqitja e dheut me përmasa me të mëdha dhe se bashku më masën drunore do të rrjedhin përgjatë lumenjve. Masa drunore, shpesh herë e përmasave të mëdha, mund të krijojë barriera të mëdha për qarkullimin e ujit dhe kjo mund të jetë një faktor ku uji mund të devijojë shtretërit e lumenjve duke krijuar përmblytje sidomos gjatë të reshurave me të mëdha.

Studime dhe hulumtime në lumenj kanë treguar se janë të pasura më florë dhe faunë. Në aspektin e florës përgjatë lumenjve dhe përreth gjendet një laramani e drunjëve dhe shkurreve si: rrapi (*Platanus orientalis*), shelgu i bardhë (*Salix alba*), verri i zi (*Alnus glutinosa*), shelgu (*Salix spec.*), frashëri (*Fraxinus excelsior*) mandej llojet me gjethe notuese si zambakët e ujit (*Nymphaea alba* dhe *Nuphar luteum*) etj. dhe të cilat po atakohen nga ndikimi i degradimit. Në këtë drejtim edhe fauna është e pasur me llojllojshmëri: tritoni (*Triturus vulgaris* - shtojca IV e Direktivës së Habitaveve), bretkoca barkverdhë (*Bombina variegata* - shtojca IV Direktiva e Habitaveve), bretkosa e gjelbërt (*Rana esculenta* - Shtojca V Direktiva e Habitaveve), dhe gjarpëri i ujërave - bollujca (*Natrix natrix* - Shtojca IV e Direktivës së Habitaveve, breshka e ujit (*Emys orbicularis*) etj. Lumenjtë janë të pasur me mbi 30 lloje peshqish si: trofta e malit (*Salmo trutta*), mustaku (*Barbus fluviatilis*), mlyshi (*Esox lucius*), krapa (*Cyprinus carpio*), perka (*Perca fluviatilis*) etj. Në lumenj tanë ende strehohen gjitarë të rrallë dhe të kërcënuar sot në shkallë botërore, si vidra (*Lutra lutra*) e cila për shkak të shkatërrimit të habitatit të saj sot shihet shumë rrallë.

Tabela 8: Analiza e zinxhirit të shkaqeve për përkeqësimin e cilësisë së ujërave

Përkeqësimi i gjendjes së lumenjve nga degradimi	
Ndikimet që rezultojnë prej përkeqësimit të gjendjes së lumenjve nga degradimi	<ul style="list-style-type: none"> - Përkeqësimi i biodiversitetit (florës dhe faunës) - Cilësia e ujit - Eutrofikimi - Pakësim i prodhimit ushqimor për faunën dhe florën e lumit - Zvogëlim i vlerës së lumit - Prishja e morfologjisë së shtratit të lumenjëve - Humbja e zhvillimit të qëndrueshëm të lumenjve - Humbja e turizmit dhe shfrytëzimi i peshkimit

10. Konkluzione dhe Rekomandime

Gjendja e lumenjve të eksploatuara nga rëra dhe zhavorri nuk është e favorshme për një proces të ripërtëritjes natyrore. Lumenjtë në disa pjesë të tyre janë në gjendje të pakthyeshme natyrore si rezultat i presionit dhe eksploatimit nga operatorët ekonomik legal dhe ilegal. Andaj, nga ky vlerësimi i gjendjes së lumenjve janë nxjerr këto **konkluzione**:

- Politikat mjedisore për mbrojtjen e lumenjve akoma janë më prioritet të ulët nga institucionet përgjegjëse;
- Lumenjtë vazhdojnë të degradohen pa kriter përkundër që ka legjislacion mjedisor që e rregullon këtë problematikë;
- Masa mbrojtëse qoftë të nivelit qendror apo lokal kanë rezultuar jo shumë efikase përkundër dhe degradimi vazhdon të ndodhë;
- Gjithashtu edhe masat për rehabilitimin e tyre dhe kthimin në gjendjen e mëparshme janë të papërfillshme;
- Në pjesë të ndryshme të lumenjve është shkatërruar plotësisht ekosistemi lumor e më këtë flora dhe fauna në këto ekosisteme;
- Lumenjtë si : Lumi Drini Bardh, Lumëbardhi i Pejës, Lumi Ereniku, Lumi Morava e Binçës, Lumi Desivojcë, Lumi Krivarek dhe Lumi Ibër janë të vlerësuar si me të degraduarit nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit;
- Lumi me i degraduar në sipërfaqe për ha është Lumi i Drinit të Bardhë më një sipërfaqe të degraduar prej 1393.04 ha dhe Lumëbardhi i Pejës më një sipërfaqe prej 257.12 ha deri në vitin 2018;
- Sipërfaqja e tërësishme e degraduar të lumenjve deri në vitin 2018 është 1762.71 ha;
- Ndryshimi i sipërfaqeve të degraduar ndërmjet viteve 2012-2018 është rritur për 543.48 ha;
- Trendi i degradimit të lumenjve ka vazhduar edhe pas vitit 2018. AMMK do të përcjellë gjendjen dhe një vlerësim tjetër ku do të rishikohet procesi i degradimit të lumenjve deri në vitin 2022, do të bëhet pasi të jenë në dispozicion imazhet satelitore përkatëse.

Në bazë të gjeturave nga ky raport janë dhënë edhe disa **rekomandime** për përmirësimin e gjendjes:

- MMPHI si institucioni kryesor që administron me lumenjtë të krijon politika afatgjatë për mbrojtjen e qëndrueshme nga degradimi i këtyre ekosistemeve dhe resurseve;
- Inspektoratet e MMPH, KPMM, PK-së dhe inspektoratet komunale të mjedisit të bashkërendojnë veprimet e përbashkëta duke përpiluar plan të detajuar për parandalimin e degradimit të lumenjve nga operatorët legal dhe ilegal;
- Të merren masa ligjore ndaj eksploatuesve ilegal dhe legal në rastet e mbi shfrytëzimit dhe eksploatimit pa kritere të rërës dhe zhavorrit;
- Të rriten taksat dhe rentat për shfrytëzuesit e rërës dhe zhavorrit që janë identifikuar si degradues të lumenjëve;
- Autoriteti Regjional i Pellgjeve Lumore (ARPL) të monitoroj dhe vlerësoj gjendjen e lumenjve rregullisht, dhe të pamundësohet operatoreve degradues operimi i tyre;
- Autoritetet policore të marrin masa konkrete ndaj veprimeve ilegale dhe të hartojnë plane operativ konkrete për këto aktivitete;
- Të realizohen projekte për zonat e degraduara të lumenjve, të rivitalizohen dhe të kthehen në gjendjen natyrore në rastet kur kjo është e mundur.

Raporti

Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve
është përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
në mbështetje edhe të njësive tjera të MMPHI

Raporti u përgatit nga :

Tafë Veselaj, DVGJM/AMMK, kryesues
Përparim Gashi, DVGJM/AMMK, anëtar
Ali Sefaj, DVGJM/AMMK, anëtar
Arton Ramadani, IM/MMPHI, anëtar
Hasan Hasani, IHMK/AMMK, anëtar
Osman Fetoshi, DMMU/MMPHI, anëtar
Sylejman Latifi, ARPL/MMPHI- anëtar

Adresa e AMMK-së:

Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04

Tel. +381 38 200 33 228 , email: ammk@rks-gov.net

Gusht, 2022